

**VENDIM**  
**Nr. 703, datë 9.9.2020**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË  
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, TË PRONËS SHETETËRORE ME  
NOMENKLATURË K-34-112-127-D, ME NUMËR PASURIE 402, 403, 404, 405, 406, 410  
(NUMËR 19 SIPAS HARTËS SË KADASTRËS DAMT), 411 (NUMËR 20 SIPAS  
HARTËS SË KADASTRËS DAMT), 412, 413 e 414, ZONA KADASTRALE NR. 2443,  
BASHKIA FIER, NJËSIA ADMINISTRATIVE LIBOFSHË, DHE TË PRONËS  
SHETETËRORE SIPAS HARTËS TREGUESE, ME NOMENKLATURË K-34-111-(111-  
D), ME NUMËR PASURIE 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1,  
227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, ZONA KADASTRALE NR.  
2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE REMAS, BASHKIA DIVJAKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me nomenklaturë k-34-112-127-d, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, Njësia Administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore me nomenklaturë k-34-111-(111-d), me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas anekseve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, do të përdoren për zhvillimin e projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik, në zonën e Remas, Divjakë – Karavasta, Lushnjë.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i lejohe vënia në dispozicion e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, shoqërisë së shpallur fituese nga procesi konkurrues i zhvilluar nga ministria, për të gjithë kohëzgjatjen e tij, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar.

4. Vendimi nr. 727, datë 8.12.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-112-127-d, me numër pasurie 402, 403, 404, 405, 406, 410 (numër 19 sipas hartës së kadastrës DAMT), 411 (numër 20 sipas hartës së kadastrës DAMT), 412, 413 e 414, zona kadastrale nr. 2443, Bashkia Fier, Njësia Administrative Libofshë, dhe të pronës shtetërore sipas hartës treguese, me nomenklaturë k-34-111-(111-d), me numër pasurie 220/1, 220/3, 221/1, 221/3, 224/1, 225/1, 226/1, 227/1, 227/3, 228/1, 228/3, 229/1, 229/3, 230/1, 231/1 e 232/1, zona kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, në fondin e pasurive të paluajtshme, për mbështetjen e investimeve strategjike dhe vënien në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik 'Albpanel'", shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

ANEKS I  
ZONA KADASTRALE NR. 2443, BASHKIA FIER, NJËSIA ADMINISTRATIVE  
LIBOFSHË

Nr. rendor Njësia administrative Zona kadastrale Numri i parcelës Sipërfaqe në m<sup>2</sup>

1. Libofshë 2443 402 96400
2. 403 98200
3. 404 92200
4. 405 96900
5. 406 97700
6. 410
- (nr. 19 sipas hartës së kadastrës DAMT) Nevojitet regjistrim fillestar
7. 411
- (nr. 20 sipas hartës së kadastrës Nevojitet regjistrim fillestar DAMT)
8. 412 90800
9. 413 98300
10. 414 98300

ANEKS II  
ZONA KADASTRALE NR. 2085, KARAVASTA E RE, NJËSIA ADMINISTRATIVE  
REMAS

Nr. rendor Njësia administrative Zona kadastrale Numri i parcelës Sipërfaqe në m<sup>2</sup>

1. Remas 2085 220/1 33774
2. 220/3 64593
3. 221/1 18548
4. 221/3 148757
5. 224/1 166155
6. 225/1 149506
7. 226/1 144257
8. 227/1 14668
9. 227/3 64766
10. 228/1 16256
11. 228/3 90262
12. 229/1 11132
13. 229/3 98642
14. 230/1 81900
15. 231/1 72360
16. 232/1 34410